

Shkrimtarët shqiptarë në Amerikë promovojnë emrin e letrave shqipe edhe në diasporë.

# ME PENAT TONA TA ÇOJMË NË VEND DINJITETIN E POPULLIT SHQIPTAR EDHE LARG ATDHEUT

*"Të përballojmë jetën me atdheun larg nesh, por me mallin në shpirtin e tonë dhe të vezullojë flaka e krijimit edhe në shpirtin tonë krijues", - ishte porositja shkrimtarit Naum Prifti, kryetari i Shoqatës së Shkrimtarëve Shqiptaro-Amerikanë.*

*Nga Nju Jorku (SHBA): Beqir SINA*

MANHATTAN NY: Restoranti Macelleria 48str, Manhattan - Nju-Jork, pronë e bashkatdhetarit tonë dhe e aktivitetit të njohur z. Sabit Bytyçi, është bërë një arenë madhe e aktiviteve kulturore, e Shoqatës së Shkrimtarëve Shqiptaro-Amerikanë. Në këtë mes promovohen libra dhe mbahen manifestime të ndryshme kulturore që mbajnë gjallë shpirtin arbëror të komunitetit shqiptar që jeton në Amerikë.

Në këtë aurole të madhe letrare-artistike, padyshim që është krijuar e vepron edhe Shoqata e Shkrimtarëve Shqiptaro-Amerikanë, e cila ka në gjirin e saj 33 anëtarë, midis tyre, emra të njohur të letrave shqipe në Shqipëri, Kosovë, Mal të Zi, Maqedoni, Kosovën Lindore, Çamëri e diasporë. Nëse shfletojmë faqet e revistës "Pena", e përkohshme letrare, zëdhënëse zyrtare e Shoqatës së Shkrimtarëve Shqiptaro-Amerikanë, do t'i hasim këta emra të shkrimtarëve: Adnan Mehmeti, Albana Melyshi Lifschien, Andon Kote, Andon Dede, An-

ton Çefa, Ferhat Mymeri, Genc Leka, Gjeto Turmalaj, Julia Naçi-Gjika, Kolec Traboini, Kreshnik Ndreu, Lekë Gjoka, Luigj Çekaj, Marsh Mali, Naum Prifti (kryetar), Ndue Hila, Nikolin Narkaj, Përparim Hysi, Petraq Pali, Qazim Rrushaj, Ramiz Gjini, Rozi Theohari, Sabije Dervishi - Veseli, Sami Miloshi (skëretar), Sidorela Risto, Skifter Këllici, Sotir Andoni, Spiro Gjickondi, Thanas Gjika, Tomë Paloka, Ukë Lushi, Viktor Martini e Ymet Abdullahi Risi e kësaj shoqate është se për herë

të parë, në botën e letrave shqipe në Amerikë, ekspozohet me vull numër kaq i madh shkrimtarësh poetësh, prozatorësh, publicistësh gazetarësh nga të gjitha trojet etn. Një pjesë e mirë e tyre janë edhe anëtarë të shoqatës e kontrës të revistës "Pena", organ zyrtar i shoqatës. Poeti Agron Tufa, në revistën "Shqipëria" në revistën "Pena" në vargje thotë "Shqipëria" është e madhe se toka e saj..... s'është pjesë planeti, por yll, Loti Zotit i pati pikuar.



Pronari i lokalit "Macelleria" akvisti i komunitetit shqiptar Sejdi Bytyqi



Aktori dhe dramaturgu Xhevat Limani, shkrimtarja Albana Melyshi-Lifschien, Gjekë Marinaj, shkrimtari Ramiz Gjini

Gjekë Marinaj, Bytyqi, Prifti

Themeluesi i Shoqatës njkohësisht drejtor i saj, pran Zyrës Amerikane N.P.O. në Ëashington DC, shkrimtari Gjokë Marinaj, deklaroi ekskluzivisht për gazetën kombëtare "Bota sot", se është i kënaqur për rezultatet që ka arritur deri tani kjo shoqatë e shkrimtarëve që veprojnë në SHAB. "Ne kemi arritur, tha ai, të ripërtërijmë traditën e lashtë shqiptare duke krijuar një atmosferë krijimtarie, njësojë si në vendlindje edhe pse tash e sa vjet jetojmë larg vendlindjes". Marinaj më tej vlerëson lart punën e shkrimtarëve në planin kombëtar, duke mos e ndarë atë nga ajo që ndjekin edhe shoqatat e tjera komunitare, sepse shumica e anëtarëve janë shkrimtarë e poetë, të arsimuar dhe me kulturë të lartë kombëtare e artistike, por edhe veteranë që dinë edhe gjuhë të huaja.

"Të përballojmë jetën me atdheun larg nesh, por me mallin në shpirtin tonë dhe të vezullojë flaka e krijimit edhe në shpirtin tonë krijues", - ishte porosia shkrimtarit Naum Prifti. Historikisht diaspora ka rolin e saj të madh në letërsinë shqipe, në saje të shumë veprave e kryeveprave letrare brënda dhe jashtë kufijve administrativë, në shkolla e mjedise të ndryshme prej De Radës, Naimit, Çajupit, Nolit, Konicës, Arshi Pipës e të tjerëve.

Prifti, iu drejtua të pranishmeve me fjalët se ne po e përtërijmë këtë traditë duke i krijuar mundësi secilit prej nesh, që të shpalosë edhe një herë vlerat e veta më të mira, në pusin e harresës dhe të humbjes së identitetit. Në këtë aspekt, mund të quhet edhe sukses i madh i shoqatës sonë, krijimi i revistës "Pena", kryesisht me krijime e vepra të antarëve të shoqatës sonë. Sipas shkrimtarit Naum Prifti për herë të parë, shfaqet një shoqatë e tillë në Amerikë dhe një revistë re e këtij niveli dhe e kësaj madhësie. Prandaj, tha ai, ne duhet të jemi krenarë për shoqatën, pa rënë në vetëmburrje dhe eufori. Të dëgjojmë ata që na kritikojnë dhe të dimë t'u përgjigjemi me dinjitet, të gjithë atyre që na etiketojnë me cilësime të cilat ne nuk na përkasin. Askush nuk mund ta thyejë moralin tonë të lartë, që kemi nisur një aktivitet të vyer gjatë këtyre katër vjetësh pune. Në vazhdim Naum Prifti tha se shoqata jonë është krijuar që të mos synojë fitime materiale, por na duhet me domosdo të synojmë diçka tjetër edhe më të vështirë, dinjitetin, dhe nderimin e komunitetit e mbarë kombit shqiptar. Dhe kjo mund të arrihet vetëm me punë dhe përkushtim, profesionalizëm, zotësi, aftësi, energji e mjete financiare. Neve na bie barra e rëndë që të mbushim atë boshllëkun e krijuar në letërsinë shqipe, në pasqyrimin e veprës së mërgimtarëve, ta vlerësojmë dhe të kemi një retrospektivë të krijimeve e veprave të cilat edhe në kohën e diktatorit mbartnin mendimin e lirë e të pacensuruar, përfundoi fjalën e tij kryetari i Shoqatës së Shkrimtarëve Shqiptaro-Amerikanë, shkrimtari i njohur Naum Prifti.

Zoti Qazim Rrushaj i cili vinte nga Bostoni ua rikujtoi edhe njëherë shkrimtarëve e artistëve shqiptarë në Amerikë se kur nëpër burgje, kampe internimi, torturoheshin intelektualët opozitarë kundër diktaturës, kur pranvera e një pjese të rinisë shqiptare dergjej në ferrin e diktaturës së bashku me talentët e tyre letrarë e

artistikë dhe ata varroseshin në varreza pa emër, çakënjtë e diktaturës i thurin lavdi diktatorit para botës.

"Sipas tyre, tha z. Rrushaj, Shqipëria na ishte një "parajsë", "kopsht me lule", në një kohë që ishte ferr. Por, në të vërtetë, njolloseshin njerëzit e vlefshëm e të ndershëm, Konica, Atë Gjergj Fishta, Atë Pjetër Mashkalla, e të tjerë. Duke cituar sociologun e madh amerikan, Ralph Wolde Emerson z. Rrushaj thotë: "S'ka gjë më të neveritshme dhe më të turpshme, kur skllavi i thur lavde skllavërisë duke e quajtur atë liri". Por, iku e djeshmja dhe ndoshta sot në këtë sallë jemi e djeshmja dhe e sotmja dhe do zoti që të jemi vëllezër prej Nënës Shqipëri. Vendi ku jetojmë ne sot na jep të gjitha mundësitë për të korriguar gabimet e mëparshme, politike-letrare, ashtu si studenti hartimin e vetëm në shkollë. Sot, kjo sallë duhet të shënojë një ditë të rëndësishme artistike-letrare, për të premtuar se si vëllezër shqiptarë pa shtyrë njëri-tjetrin me bërryla dhe të përpiqemi të hyjmë ashtu siç e meritojmë në këtë shekull, që t'i sjellim kombit atë që i mungoi për më se 50 vjet e që na la nja një shekull mbrapa. "Me penat tona, të punojmë e krijojmë që të çojmë në vend dinjitetin e popullit shqiptar të nëpërkëmbur e shkretuar keqaz nga diktatura e diktatori. Për të vënë në vend dhe ngritur në pedestal, rreshtuar në njëllor me kombet e qytetëruara e të civilizuara, të jemi aty ku na takon dhe e meritojmë. Kjo rrugë e re do të na bëjë ne të gjithëve, që të jemi krenar e të na jenë mirënjohës brezat që do të na vinë pas", -tha në fund të fjalës së tij zoti Qazim Rrushaj, anëtar i shoqatës.

Editori i gazetës "Dielli", zoti Anton Çefa, shkrimtar, gazetar e publicist, tha se pa mohur punën që kemi bërë deri tash në fushën e letrave shqipe, mendoj se duhet punuar edhe më shumë në të gjitha mënyrat. Ai solli si shembull me këtë rast një revistë kulturore-artistike vëllimore të dy vëllezërve shqiptarë me banim në Rumani. Shkrimtari, Genc Leka, u përkushtua shkurt tek simbolet shqiptare dhe vlera e tyre duke sjellë me këtë rast edhe një studim historik, për ngjyrrat e flamurit kombëtar, si dhe një poezi të zgjedhur për t'iu përshtruar mendimit të tij. Ndërkaq në një pronocim të tij poeti Petraq J. Pali, i cili kishte ardhur nga Virginia, tha se qëllimi i ngritjes së kësaj shoqate është hapi i parë dhe mjaft shpresëdhënës në fushën e letërsisë. Secili nga ne do të bëhet një mis-hërues dhe transmetues i ndjenjave dhe traditave me të shkëlqyera kombëtare, me krijimet dhe veprat e tyre në diasporë, për t'ua lënë trashëgim brezave që do të na vinë pas. Me këtë rast u lexuan dhe telegramet përshëndetëse drejtuar këtij takimi dhe shoqatës nga shkrimtari i mirnjohur Agim Shehu nga Zicra e Piter Prifti nga ShBA-të. Ndërkaq aktori dhe dramaturgu i mirnjohur i artit skenik z. Xhevat Limani, pasi përshëndeti takimin dhe i uroi suksese shoqatës, me pasion dhe nivel të lartë artistik, interpretoi pjesë nga poema "Bagëti bujqësi" e Naim Frashërit.



Shkrimtari Genc Leka me librin "Shqipëria"



Nje grup pjesmarresish nga takimi i shoqates se shkrimtarve shqiptaro - amerikan

**EUROTRANS FINANZ AG**  
Bahnhofplatz 3 - CH 8001 Zürich

Transfer brenda një dite

Transfer i shpejtë dhe i sigurtë i të hollave tuaja nga Zvicra për në Kosovë dhe Maqedoni. Eurotrans Finanz AG gjendet në çdo përfaqësi të Reisbüro Prishtina në Zvicër, Kosovë dhe Maqedoni. Poseedojmë licencë dhe autorizim.

Tel. 043 344 80 80

Natel 079 858 42 21

Tel. 043 344 80 82